



Ironë Lajçati

Qdhy

I. Honopoli Thunf



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 755/ Prot.

Vlorë më, 11 . 04 .2023

VENDIM
Nr. 17, datë 07.04.2023

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER
PROFESIONAL "UDHËRRËFIM DHE KOMUNIKIM TURISTIK"

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionit dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", si dhe referuar propozimit të ZV/Rektorit Akademik ardhur me shkresën nr.687/1 prot, datë 05.04.2023 Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.04.2023

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e programit të studimit Master profesional në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik" ofruar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si dhe Zëvendësrektorit Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV/REKTOR AKADEMIK**

Nr. 687 / Prot

Vlorë, më 05.04.2023

Lënda: Relacion për miratimin e rregullores së programit të ri të studimit : "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë.

**PROF. DR. ROLAND ZISI
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

Bazuar në shkresën e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë me nr. 687, datë 31.03.2023, "Përcjellje për miratim në Senatin akademik të rregullores së programit të studimit, "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, po ju përcjellim relacionin e përmbledhur si më poshtë:

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në udhëzimin nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Programi i studimit "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.

Ky program studimi është program i ciklit të dytë, "Master profesional", i cili ofrohet në një vit akademik, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 60 kredite (ECTs) dhe merr diplomën "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik".

Përveç njësive bazë dhe kryesore, programi do të realizohet edhe me mbështetjen e entiteve shtetërore dhe private që nxisin dhe promovojnë biznesin turistik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV/REKTOR AKADEMIK

Ky program synon përgatitjen e specialistëve në fushën e turizmit, të aftë për të punuar si udhërrëfyes turistikë, ndërmjetësues turistikë, agjentë turistikë, interpretues turistikë, të pajisur me:

- a) njohuri të përgjithshme rreth historisë, gjeografisë dhe trashëgimisë dhe pasurive kulturore e natyrore të vendit;
- b) njohje të koncepteve bazë të udhëtimit, udhërrëfimit, marketingut, mikpritjes etj të lidhuar me to;
- c) formim të plotë kulturor, duke vënë kryesisht theksin tek njohja kulturore dhe kompetenca ndërkulturore si thelbësore në ndërveprimin me të huajt dhe turistët në veçanti;
- d) formim profesional, të plotë e bashkëkohor në teknikat e udhërrëfimit, sjelljen e konsumatorit;
- e) formim të kompetencave të nevojshme për krijimin e profilin profesional të udhërrëfyesit dhe interpretuesit turistik (njohuri, shprehje, etikë profesionale, menaxhimi turistik, lidhshmëri, përgjegjshmëri, korrektesë etj.)
- f) aftësi për të komunikuar në dy gjuhë të huaja (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht) në mjedis pune dhe situata komunikimi gjatë udhërrëfimit dhe interpretimit për qëllime turistike;
- g) njohuri të plota në lidhje me strukturën dhe funksionimin e gjuhëve të studimit (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht);
- h) njohuri përreth kulturës së vendeve gjuhën e së cilës studjojnë;
- i) aftësi për të ndërtuar marrëdhënie komunikimi dhe pune në një mjedis ndërkulturore;
- j) njohuri të plota rreth kontekstit ligjor evropian dhe kombëtar për turizmin;
- k) aftësi për të kryer kërkim në fushën e studimit të kryer.

Kurrikula e programit të studimit "Master profesional në udhërrëfim dhe komunikim turistik" organizohet në:

- a) Lëndë bazë;
- b) Lëndë karakterizuese;
- c) Lëndë ndërdisiplinore/ integruese;
- d) Lëndë plotësuese;
- e) Detyrime përmbyllëse.

Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit së cilës i përket dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kurset/lëndët me kode "ENG ..." zhvillohen në gjuhën angleze, me "ITA ..." në gjuhën italiane, me "ALB ..." në gjuhën shqipe, me "FRE ..." në gjuhën frënge, me "SPA ..." në gjuhën spanjolle, me "GEO" dhe "HIS" në gjuhën shqipe dhe ofrohen nga Departamenti i Edukimit, me "COM" nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, me "CS..." ofrohen nga Departamenti i Informatikës, me "TUG" janë kurse/lëndë apo veprimtari tipike të programit (tour guiding), me "TUR" nga fusha e turizmit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV/REKTOR AKADEMIK

Përmbajtja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar etj. paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.

Bashkëlidhur rregullorja e plotë e programit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

ZV/REKTOR AKADEMIK

Prof. As. Frosina Qyrdeti



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË

DEKANI

ZYRA E PROJEKTOULL - ARKIVËS

NR. 687 PROT.

DATA 31.03.2023

Nr. 213/ Prot.

Vlorë, më 31.03/2023

Lënda: Përcjellje për miratim në Senatin Akademik të rregullores së programit të ciklit të dytë të studimit "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik"

**KRYETARIT TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "ISMAIL
QEMALI", VLORE, PROF.DR.ROLAND ZISI**

KËTU

I nderuar Z.Kryetar,

Në përmbushje të detyrimeve për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim, pas njoftimit të kalimit të fazës së parë me shkresë të MAS-it me nr. 2043 prot., datë 28.03.2023 "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimit", bashkëlidhur po Ju përcjellim për miratim nga Senati Akademik rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimit "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik", propozuar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.



Prof. Dr. Armina Panajoti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANË DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Nr. 213 prot.

Vlorë, më 31.03. 2023

Lënda: Vendim për miratimin e rregullores së programit të studimit të ciklit të dytë
"Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik" në DGJH.

PROF. AS. DR. ARMELA PANAJOTI, DEKANE E FSHHD-së

Këtu

Mbështetur në nenin 25 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë," VKM nr. 41, datë 24.01.2018, Rregulloren e UV, neni 64 'Programet e ciklit të dytë të studimeve', Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në mbledhjen e radhës, datë 31.03.2023, miratoi rregulloren e programit të studimit "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik". Bazuar në procedurat dhe legjislacionin në fuqi, kërkojmë përcjelljen e këtij vendimi për miratim të mëtejshëm nga Senati Akademik. Bashkëlidhur rregullorja e programit "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

PËRGJEGJËS DEPARTAMENTI

Prof. As. Dr. Veneranda Hajrulla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL NË "UDHËRRËFIM DHE KOMUNIKIM TURISTIK"**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në udhëzimin nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

1. Programi i studimit "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Fakultetit të Shkencave Teknikë dhe Natyrore.
2. Ky program studimi është program i ciklit të dytë, "Master profesional", i cili ofrohet në një vit akademik, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 60 kredite (ECTs) dhe merr diplomën "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik".
3. Përveç njësive bazë dhe kryesore, programi do të realizohet edhe me mbështetjen e entiteve shtetërore dhe private që nxisin dhe promovojnë biznesin turistik.

Neni 2

Objektivat formues të programit

1. Ky program synon përgatitjen e specialistëve në fushën e turizmit, të aftë për të punuar si udhërrëfyes turistikë, ndërmjetësues turistikë, agentë turistikë, interpretues turistikë, të pajisur me:
 - a) njohuri të përgjithshme rreth historisë, gjeografisë dhe trashëgimisë dhe pasurive kulturore e natyrore të vendit;
 - b) njohje të koncepteve bazë të udhëtimit, udhërrëfimit, marketingut, mikpritjes etj të lidhuar me to;
 - c) formim të plotë kulturor, duke vënë kryesisht theksin tek njohja kulturore dhe kompetenca ndërkulturore si thelbësore në ndërveprimin me të huajt dhe turistët në veçanti;
 - d) formim profesional, të plotë e bashkëkohor në teknikat e udhërrëfimit, sjelljen e konsumatorit;
 - e) formim të kompetencave të nevojshme për krijimin e profilit profesional të udhërrëfyesit dhe interpretuesit turistik (njohuri, shprehje, etikë profesionale, menaxhimi turistik, lidhshmëri, përgjegjëshmëri, korrektesë etj.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- f) aftësi për të komunikuar në dy gjuhë të huaja (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht) në mjedis pune dhe situata komunikimi gjatë udhërrëfimit dhe interpretimit për qëllime turistike;
- g) njohuri të plota në lidhje me strukturën dhe funksionimin e gjuhëve të studimit (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht);
- h) njohuri përreth kulturës së vendeve gjuhën e së cilës studjojnë;
- i) aftësi për të ndërtuar marrëdhënie komunikimi dhe pune në një mjedis ndërkulturore;
- j) njohuri të plota rreth kontekstit ligjor evropian dhe kombëtar për turizmin;
- k) aftësi për të kryer kërkim në fushën e studimit të kryer.

Neni 3

Disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit sipas krediteve

1. Kurrikula e programit të studimit "Master profesional në udhërrëfim dhe komunikim turistik" organizohet në:

- a) Lëndë bazë;
- b) Lëndë karakterizuese;
- c) Lëndë ndërdisiplinore/ integruese;
- d) Lëndë plotësuese;
- e) Detyrime përmbyllëse.

2. Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit së cilës i përket dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kurset/lëndët me kode "ENG ..." zhvillohen në gjuhën angleze, me "ITA ..." në gjuhën italiane, me "ALB ..." në gjuhën shqipe, me "FRE ..." në gjuhën frënge, me "SPA ..." në gjuhën spanjolle, me "GEO" dhe "HIS" në gjuhën shqipe dhe ofrohen nga Departamenti i Edukimit, me "COM" nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, me "CS..." ofrohen nga Departamenti i Informatikës, me "TUG" janë kurse/lëndë apo veprimtari tipike të programit (tour guiding), me "TUR" nga fusha e turizmit.

3. Përmbajtja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar etj. paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.

4. Më poshtë paraqitet lista e disiplinave dhe veprimtaritë formuese të programit të shprehura të ndara në kredite për disiplinë dhe tipin e komponentit mësimor si vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme:
6 kredite

TUG 441 Teknika të udhërrëfimit turistik	2 kredite
TUR 443 Bazat e udhëtimit dhe turizmit	2 kredite
DRE 422 Legjislacion kombëtar dhe evropian për turizmin	2 kredite

B. LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore:
24 kredite

ENG 431 Anglishte për komunikim turistik 1 (B2)	4 kredite
ENG 432 Anglishte për komunikim turistik 2 (C1)	4 kredite
ALB 440 Trashëgimi kulturore	4 kredite
GEO 450 Gjeografia turistike e Shqipërisë	4 kredite
TUR 452 Menaxhim destinacionesh e itinaresh turistike	4 kredite
HIS 451 Histori e qytetërimit shqiptar	4 kredite

**C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-
lëndë me zgjedhje: 18 kredite**

COM 452 Komunikim ndërkulturor	4 kredite
<i>Zgjidh një nga :</i>	4 kredite
ITA 431 Italisht (B2)/FRE 431 Frëngjisht (B2)/GER 431 Gjermanisht (B2)/SPA 431 Spanjisht (B2)	
<i>Zgjidh një nga :</i>	4 kredite
ITA 432 Italisht (C1)/FRE 432 Frëngjisht (C1)/GER 432 Gjermanisht (C1)/SPA 432 Spanjisht (C1)	
<i>Zgjidh një nga :</i>	4 kredite
COM 454 Studime të komunikimit /ART 455 Histori arti /ALB 454 Histori e besimeve fetare	
TUR 455 Sjellje e konsumatorit në turizëm dhe mikpritje	2 kredite

D. LËNDË PLOTËSUESE –gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale: 6 kredite

CST 446 Komunikim dhe teknologji e informacionit për	2 kredite
--	-----------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANË DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

turizmin

TUG 490 Praktikë profesionale

4 kredite

E. DETYRIME PËRMBYLLËSE: 6 kredite

TUG 489 Provim përfundimtar/Punim diplome

6 kredite

**Neni 4
Plani mësimor**

1. Më poshtë paraqitet plani mësimor i studimit, i detajuar me semestra, me disiplinat dhe veprimtaritë formuese përkatëse të programit të shprehura të ndara në kredite, orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit për disipline si vijon:

Viti	Semestri	Kodi	Emri i Enda	Kreditë	Total orë/ semestër brenda e jashtë auditorit	Total orë/ semestër në auditorit	Total orë/ javë në auditorit		Total orë jashtë auditorit detyra
							lex	sem	
Viti I	Sem. I	ENG 431	Anglisht për komunikim turistik 1 (B2)	4	100	60	1	3	40
		HIS 451	Histori e qytetërimit shqiptar	4	100	45	2	1	55
		ALB 440	Trashëgimi kulturore	4	100	45	2	1	55
		GEO 450	Gjeografia turistike e Shqipërisë	4	100	45	2	1	55
		Zgjidh një nga: COM 454 /ART 455 /ALB 454	Zgjidh një nga: Studime të komunikimit /Histori arti /Histori e besimeve fetare	4	100	45	2	1	55
		Zgjidh një nga: ITA 431/FRE 431/GER 431/SPA 431	Zgjidh një nga: Italisht 1 (B2)/Frëngjisht 1 (B2)/Gjermanisht 1 (B2)/Spanjisht 1 (B2)	4	100	60	1	3	40
		COM 452	Komunikim ndërkulturore	4	100	45	2	1	55
		CST 446	Komunikim dhe teknologji e informacionit për turizmin	2	50	30	1	1	20
		TOTALI		30	750	375	11	12	375
		ENG 432	Anglisht për komunikim turistik 2 (C1)	4	100	60	1	3	40
Viti II	Sem. II	TUG 441	Teknika të udhërrëfimit turistik	2	50	30	1	1	20
		TUR 443	Bazat e udhëtimit dhe turizmit	2	50	30	1	1	20
		TUR 452	Menaxhim destinacionesh e itlneraresh turistike	4	100	45	2	1	55
		DRE 422	Legjislacion kombëtar dhe evropian për turizmin	2	50	30	1	1	20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

TUR 455	Sjellje e konsumatorit në turizëm dhe mikpritje	2	50	30	1	1	20
Zgjidh një nga: ITA 432/FRE 432/GER 432/SPA 432	Zgjidh një nga: Italisht 2 (C1)/Frëngjisht 2 (C1)/Gjermanisht 2 (C1)/Spanjisht 2 (C1)	4	100	60	1	3	40
TUG 490	Praktikë profesionale	4	100	0	0	0	0
TUG 489	Provim përfundimtar/Punim diplome	6	150	0	0	0	0
TOTALI		30	750	285	8	11	400

Neni 5

Përshkrimi i disiplinave që ndërthhen programi

1. Ky program studimi ndërthhen këto disiplina dhe detyrime akademike, përshkrimet e të cilave paraqiten si vijon:

a) **ENG 431 Anglisht për komunikim turistik 1 (B2):** Ky kurs synon përgatitjen e studentëve për të përdorur gjuhën angleze për qëllime turistike duke u bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale. Niveli i njohurive i përket nivelit B2 sipas dokumentit evropian "Kuatridi i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët".

b) **HIS 451 Histori e qytetërimit shqiptar:** Lënda 'Histori e qytetërimit shqiptar' synon t'u japë studentëve të drejtimit 'master profesional' disa njohuri bazë për konceptin e 'qytetërimit shqiptar'. Fillimisht do të trajtohet ai nga pikëpamja teorike dhe pastaj do të synohet që koncepti i 'qytetërimit shqiptar' të shtjellohet edhe si ligjërime dhe i lidhur ngushtë me atë që shihet si 'identiteti kombëtar'. Mendojmë se një qasje e tillë do t'u japë studentëve mundësinë ta shohin qytetërimin shqiptar si një fenomen të lëvizshëm, që nuk është statik, por që është gjithmonë në një proces formulimi dhe riformulimi. Nga ana tjetër, një qasje e tillë do të mund të tregojë se ajo që shpesh përfytyrohet si 'qytetërim shqiptar' i dhënë një herë e përgjithmonë është në të vërtetë produkt i shtresëzimeve kulturore të ndryshme që vijnë përgjatë shekujve. Nje vend të rëndësishëm do të zërë në leksione edhe diskutimi mbi vendin e 'qytetërimit shqiptar', është ai në Lindje apo në Perëndim.

c) **ALB 440 Trashëgimi kulturore:** Kursi "Trashëgimi kulturore" është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me pasurinë kulturore dhe trashëgimore të popullit shqiptar, parë në kontekstin e turizmit dhe asaj që është tërheqëse dhe ngjall interes tek turistët dhe vizitorët e huaj, por jo vetëm.

Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- mendojnë në mënyrë kritike për historinë, qytetërimin, kulturen dhe artin shqiptar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- identifikojnë qasjet dhe veçoritë karakteristike të trashëgimisë kulturore shqiptare.
- kultivojnë shijen dhe gjykimin për objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare.
- të kuptojnë fillesat e zhvillimeve kulturore dhe historike shqiptare.
- përdorin burime të ndryshme dhe të larmishme studimore për të vlerësuar trashëgiminë kulturore shqiptare.

d) **GEO 450 Gjeografia turistike e Shqipërisë:** Programi që zhvillohet nëpërmjet lëndës "Gjeografi turistike e Shqipërisë" paraqet interes për studentët e këtij programi studimi, specialistët e kësaj fushe, por edhe për të gjithë të interesuarit rreth dukurisë 'turizëm'. Një interesim i tillë lidhet me rëndësinë që ka kudo në botë turizmi, si një nga aktivitetet më të rëndësishme të ekonomisë botërore me efekte të shumanshme ekonomike, sociale, mjedisore etj, ashtu edhe në rëndësinë që ka marrë turizmi pas vitit 1990 për Shqipërinë.

Bazuar në këtë rëndësi, ai është bërë këto vitet e fundit objekt studimi i shumë shkencave edhe në Shqipëri. Vend të rëndësishëm ka marrë studimi gjeografik i turizmit.

e) **COM 454 Studime të komunikimit:** Studime të komunikimit është një kurs i projektuar për studentët e programit "Master profesional në udhërrëfim dhe komunikim turistik", i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuri të mëtijshme dhe të kuptojnë teorinë e komunikimit ndëraktiv. Ky kurs shqyrton koncepte teorike në kontekste relevante të studimit të komunikimit human. Përveç teorisë gërshetohen dhe studimet e rastit në praktikë në formën e vizitave, workshop-eve, pjesëmarrjes në konferenca apo leksione të hapura në universitete të ndryshme në Shqipëri, si dhe takime me organizata joqeveritare, për të krijuar njohuri më të qarta për faktorë dhe medie të ndryshme komunikimi.

f) **ART 455 Histori arti:** Kursi 'Histori arti' është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e artit dhe historisë së artit, metodologjitë kryesore për të kuptuar artin, ide të ndryshme rreth përfaqësimit të gjinisë, formës dhe seksit në art, lidhjen e artit me psikanalizën, semiotikën dhe Marksizmin, sesi po ndikon globalizimi dhe postmodernizmi tek arti dhe ndryshimet në art etj.

Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- mendojnë në mënyrë kritike si për historinë, ashtu edhe për artin.
- identifikojnë qasjet dhe veçoritë karakteristike ndër veprat e llojet e ndryshme të arteve duke u bazuar tek periudha/stili/temat.
- kultivojnë shijen dhe gjykimin për të gjitha stilet e artit.
- lidhin veprat e ndryshme të artit me fillesat e tyre kulturore dhe historike.
- përdorin burime të ndryshme dhe të larmishme studimore për të vlerësuar artin në periudha dhe stile të ndryshme.

g) **ALB 454 Histori e besimeve fetare:** Kursi 'Histori e besimeve fetare' është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe rolin e fesë përgjatë historisë së njerëzimit, format e ndryshme të mendimit fetar, qasjet kryesore për të kuptuar fenë/besimet e ndryshme, fetë e vjetra dhe fetë e reja etj.

Përmes këtij kursi synohet që studentët të njihen dhe mësojnë:

- sesi kanë lindur besimet.
- për rolin e tyre në jetën e njeriut.
- se përse disa besime ishin shumë të zhvilluara në një periudhë të caktuar kohore.
- se përse disa nga këto besime, edhe pse të zhvilluara asokohe, sot janë zhdukur.
- se përse disa besime janë konservatore dhe të tjera jo.
- për mendimin filozofik në besimet kryesore.
- për ndikimet e zhvillimeve e sotme sociale, politike e teknologjike në format e besimit dhe përhapjes së tyre etj.
- historikun e zhvillimit të feve në Shqipëri.

h) ITA 431 Italisht 1 (B2): Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit B2.

i) FRE 431 Frëngjisht 1 (B2): Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës frënge në dy module dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin DELF B2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën franceze. Kursi favorizon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.

j) **GER 431 Gjermanisht 1 (B2):** Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës gjermane, në dy module, dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin B2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën gjermane. Kursi synon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.

k) **SPA 431 Spanjisht 1 (B2):** Kursi 'Spanjisht 1 (B2)' ka si synim ta pajisë studentin me njohuri të gjuhës spanjolle të folur dhe të shkruar si një gjuhë ndërkombëtare. Ky kurs përmban 12 kapituj, secili prej të cilëve përfshin këto rubrika:

- Përmbytjen funksionale
- Përmbytjen gramatikore
- Tekste dhe leksik
- Komponentin strategjik (për zhvillimin e të kuptuarit tekstual)
- Përmbytjen kulturore
- Fonetikë/ortografi

Kursi parashikohet për studentët të cilët kanë disa njohuri paraprake në gjuhën spanjolle dhe dëshirojnë t'i përparojnë ato në nivelin B2.

k) **COM 452 Komunikim ndërkulturor:** Kursi 'Komunikim ndërkulturor' është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me ndërveprimin e njerëzve nga sfone të ndryshme kulturore dhe gjuhësore, sidomos në një kontekst të gjerë e të diversifikuar të shenjuar nga zhvillimet e teknologjisë, globalizimi dhe lëvizjet migratore. Të rinjtë gjithnjë e më shumë zgjedhin të studiojnë në një vend të ndryshëm nga i tyre, ndër të tjera edhe për të marrë një përvojë të re kulturore. Në këto kushte nevoja për përshtatje dhe ndërtim të marrëdhënieve ndërkulturore bëhet edhe më e madhe. Ky kurs jep shprehje bazë të të kuptuarit të kompleksitetit të komunikimit gjuhësor dhe ndërkulturor në vendndodhje të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Rrit ndërgjegjësimin për domethënien që merr anglishtja si lingua franca në një botë gjithnjë edhe më të globalizuar dhe të ndërlidhur si dhe nënvizon rëndësinë e njohjes së gjuhëve të tjera në këto kushte. Në këtë kurs paraqiten koncepte bazë të komunikimit ndërkulturor, duke vënë theksin tek zhvillimet historike në këtë fushë. Studentët nxiten për t'u përfshirë, eksploruar dhe dialoguar me të tjerët gjatë procesit të të zhvilluarit të të kuptuarit se ç'është thotë të jesh ndërkulturor. Shëmbuj nga jeta reale do të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

sillen për shqyrtim e diskutim në klasë. Synohet po ashtu rritja e ndërgjegjësimit për përmasat konjitive, afektive dhe sjellimore të kompetencës ndërkulturore dhe cilësitë që lidhen me qytetarinë globale.

l) CST 446 Komunikim dhe teknologji e informacionit për turizmin: Në këtë kurs synohet të jepen njohuri mbi teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në turizëm dhe komunikim për qëllime turistike në mënyrë që studentët të fitojnë njohje dhe kompetenca përdorimi të TIK në procesin e promovimit të turizmit dhe ofrimit të shërbimeve në turizëm për ta bërë atë sa më efektiv. Lënda do të synojë në mënyrë specifike të aftësojë studentin që të integrojë mjetet kryesore që ofron TIK në komunikimin për qëllime turistike.

m) ENG 432 Anglisht për komunikim turistik 2 (C1): Ky kurs synon përgatitjen e studentëve për të përdorur gjuhën angleze për qëllime turistike duke u bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale. Niveli i njohurive i përket nivelit C1 sipas dokumentit evropian "Kuari i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët".

n) TUR 443 Bazat e udhëtimit dhe turizmit: Kjo lëndë trajton konceptet bazë në industrinë e udhëtimit, mikpritjes, turizmit, rekreacionit, ushqimit. Kursi ndihmon studentët në hartimin e një karriere në një nga industritë më të mëdha në botë, udhëtimin dhe turizëm. Studentët do të shikojnë aspektet e ndryshme të industrisë së turizmit dhe eksplorojnë karrierat që ofron industria. Ata do të shikojnë ndikimin ekonomik dhe pasojat e zhvillimit në ekonomi. Studentët gjithashtu eksplorojnë tendencat në zhvillim dhe ndikimin e teknologjisë.

o) TUG 441 Teknika të udhërrëfimit turistik: Kjo lëndë trajton konceptet bazë të teknikave të guidimit dhe komunikimit në kushtet e një industrie turistike në rritje. Lënda është ndërtuar për të shërbyer si një hyrje në guidën praktike si dhe për guida që janë kompetentë për territorin e tyre, por që kanë nevojë të përmirësojnë teknikat e tyre të komunikimit.

Qëllimi kryesor i këtij moduli është t'i paraqesë studentëve parimet kryesore të guidimit turistik. Nëpërmjet kësaj lënde dhe seksioneve të saj kryesore synohen:

1. Aftësitë praktike të guidimit në turizëm,

2. Njohuritë e aplikueshme,

3. Studimet kulturore

4. Do të jetë e mundur të plotësohet kuadri bazë i njohurive të domosdoshme që lidhen me teknikat e guidimit, mjedisin që na rrethon, njohjen e individit/grupit dhe mundësitë për të ngritur një biznes turistik të mbështetur në këto njohuri.

p) DRE 422 Legjislacion kombëtar dhe evropian për turizmin: Turizmi sot është ndër industritë më të mëdha në botë duke krijuar më shumë vende pune sesa shumica e sektorëve të tjerë. Institucionet publike duhet të sigurojnë një legjislacion përkrahës, një kornizë institucionale e cila është e favorshme për zhvillimin e sektorit privat, si dhe të garantoj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DËPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

sigurimin e cilësisë për turistët. Ndërsa aktorët privat duhet ta njohin dhe ta zbatojnë legjislacionin përkatës.

Lënda "Legjislacioni kombëtar dhe evropian për turizmin" pasqyron zhvillimet e rëndësishme legjislative që kanë ndodhur në vendin tonë në fushën e turizmit. Vëmendje e veçantë u kushtohet çështjeve që lidhen me njohurinë për të drejtën dhe ligjin në fushën e turizmit, njërive akomoduese, agjensive turistike dhe të udhëtimit në legjislacionin Shqiptar dhe atë të Bashkimit Evropian.

p) ITA 432 Italisht 1 (C1): Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit C1.

r) FRE 432 Frëngjisht 1 (C1): Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës frënge në dy module dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin DELF C1 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën franceze. Kursi favorizon përfshirjen e studentëve në të nxënësit e tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.

s) GER 432 Gjermanisht 1 (C1): Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B2 të gjuhës gjermane, në dy module, dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin C1 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

për historinë e kulturën gjermane. Kursi synon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.

t) **SPA 432 Spanjisht 1 (C1):** Kursi 'Spanjisht 2 (C1)' ka si synim ta pajisë studentin me njohuri të gjuhës spanjolle të folur dhe të shkruar si një gjuhë ndërkombëtare. Ky kurs përmban 12 kapituj, secili prej të cilëve përfshin këto rubrika:

- Përmbajtjen funksionale
- Përmbajtjen gramatikore
- Tekste dhe leksik
- Komponentin strategjik (për zhvillimin e të kuptuarit tekstual)
- Përmbajtjen kulturore
- Fonetikë/ortografi

Kursi parashikohet për studentët të cilët kanë disa njohuri paraprake në gjuhën spanjolle dhe dëshirojnë t'i përparojnë ato në nivelin C1.

u) **TUR 452 Menaxhim destinacionesh e itinaresh turistike:** Qëllimi i lëndës është që të ofrojë aftësi për të hartuar itinaresh që integrojnë shërbimet e ndryshme turistike dhe promovojnë zhvillimin turistik të vendeve dhe mikro-teritoreve. Në këtë kuadër ndër qëllimet e tjera, përveçse fitimin e njohurive në fusha si historia apo gjeografia dhe territori apo kulturore dhe aftësitë, janë gjithashtu edhe dhënia e mundësive për studentët për të përcaktuar dhe për të menaxhuar të gjithë procesin e projektimit deri te kuantifikimi dhe menaxhimi i investimeve, duke përzgjedhur kanalet më të përshtatshme financiare dhe mjetet e komunikimit.

v) **TUR 455 Sjellje e konsumatorit në turizëm dhe mikpritje:** Në këtë kurs synohet të jepet njohuri mbi sjelljen e konsumatorit në turizëm dhe mikpritje për qëllime të përmirësimit të shërbimeve. Temat do të fokusohen në çështje si, supremacia e konsumatorit, faktorët që ndikojnë në sjellje; njohuri dhe përfshirja, vëmendja dhe të kuptuarit, qëndrimet dhe synimet; vendimmarrje e sjellje; mësimin klasik dhe operativ; ndikimet kulturore; grupet e referencës.

x) **TUG 490 Praktikë profesionale:** Praktika mësimore e studimit në terren ka si qëllim dhe synim të pajisë studentët me njohuri të drejtpërdrejta të veçorive natyrore dhe historik-kulturore të hapësirave gjeografike të përcaktuara, si dhe tregues e dëshmi të përvojës më të rëndësishme historike e politiko-kulturore të periudhave të ndryshme historike në vendin tonë.

Synimet kryesore rreth asimilimit të këtij programi nga studentët orientohen në:

-Ofertën turistike (bazat natyrore dhe kulturore të hapësirave gjeografike për zhvillimin e tyre turistik).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- Zonat më tipike natyrore me potenciale turistike dhe ato historiko-kulturore.
- Zonat me status të ndryshëm mbrojtjeje (njohja, studimi, mbrojtja, problematikat që hasim, mundësitë për zhvillimin e turizmit).
- z) TUG 489 Provimi përfundimtar: Provimi i përgjithshëm i formimit është një provim përmbyllës që jepet nga studenti vetëm pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet e tjera akademike për plotësimin e programit të studimit. Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor (C1), kulturor dhe ndërkulturor të studentit përmes ushtrimeve të larmishme për të shquar aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përfshihet nga mesatarja e të dy vlerësimeve të marra së bashkë. Provimi me shkrim do të zëjë 40% të vlerësimit, kurse provimi me gojë 60 %.

Neni 6

Format dhe organizimi i studimit të programit "Master profesional" në "Udhërrëfim dhe komunikim turistik"

1. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare,) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj).

Neni 7

Format e kontrollit të dijes

1. Programi mësimor "Master profesional në udhërrëfim dhe komunikim turistik" parashikon vlerësime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe të provimit të formimit/temës së diplomës.
2. Për modulet e koordinuara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegial i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit.
3. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, provimet e formimit, temat e diplomave.
4. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMAL' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

5. Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

- a) me shkrim,
- b) me gojë,
- c) i kombinuar, me shkrim e me gojë

duke u mbështetur në programin mësimor. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet ose vetëm përmes një provimi përfundimtar, ose përmes një provimi të pjesshëm, një provimi përfundimtar dhe/ose kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën në syllabus.

5. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen dhe firmosen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Neni 8

Kushtet për t'u konsideruar kalues në një lëndë

1. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ..., 10. Notat nga pesë e lart janë kaluese.
2. Në format e kontrollit me shkrim (provine, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimit, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).
3. Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.
4. Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjial i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 9

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Kontrolli i njohurive bëhet thjesht me një provim final, ose me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

2. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. Ky afat mund të tejkalohet deri në 72 orë në rastet kur pedagogu i lëndës ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tri ditëve nga çasti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 10

Orari i studimit dhe provimeve

1. Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimmshënësit.
2. Orari i përgjithshëm i universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë nga mbarimi i semestrit.
3. Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Neni 11

Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin

1. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%.
2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%.

Neni 12

Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

1. Detyrat dhe projektet e kursit mund të jenë disa lloje: eso ose kërkim në fushën përkatëse, projekt kërkimor, punë prezantuese, poster.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

2. Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

Neni 13
Vlerësimi për diplomim

1. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose punim diplome.
2. Studenti mesatarja e përgjithshme e të cilit është 8.5 (vlerësimet e marra në semestrin e parë), i njihet e drejta të realizojë punim diplome.
3. Punimet e diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:
 - a) Të jenë studime individuale,
 - b) Të jenë studime deskriptive apo analitike.
 - c) Me udhëheqje shkencore apo krejtësisht të pavarura,
 - d) Të ndjekin rregullat e shpallura nga DGJH për paraqitjen e punimit, bazuar në shtojcat në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 65, datë 14.11.2016, si dhe Rregulloren e punimeve të miratuar nga DGJH.
4. Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor të studentit (C1) përmes ushtrimeve gjuhësore (gramatikore dhe leksikore) dhe aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përftohet nga mesatarja e të dy vlerësimeve bashkë.

Neni 14
Modalitetet për dhënien e diplomës

1. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të dytë të studimeve në programin "Master profesional në udhërrëfim dhe komunikim turistik" janë:
2. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplnat:
 - a) e formimit bazë (3)
 - b) karakterizues (6)
 - c) ndërdisiplinore/integruese (5)
 - d) plotësuese (2)
3. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në provimin e formimit/punimin e diplomës.
4. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 60 ECTS (kredite).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANË DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

5. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studenti paraqitet pranë sekretarisë mesimore të DGJH-së për të kryer procedurat përkatëse.

Neni 15

Shkeljet e integritetit akademik

1. Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim, sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:
2. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.
3. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrashimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrashimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.
4. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.
5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterikë duke përfshirë modifikimin e skedar kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raportë laboratorit dhe ushtrime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMAL' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, apo ese origjinale ose referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 16

Dispozita të veçanta

1. Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe njësitë e tjera bashkëpunuese në këtë program kanë të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos për sa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Vlorë më, 21.03.2023

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati
- Rektorati
- Këshilli Etikës
- Rektori
 - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
 - Sektori Juridik
 - Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
 - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
 - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
 - Sektori i IT-së
- Bordi i Administrimit
- Administrator
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
 - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
 - Sektori i Prokurimeve
 - Sektori i Shërbimeve
- Njësia e Auditës të Brendshëm
- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
 - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
 - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
 - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik
- Zv. Rektor Akademik
 - Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë
 - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
 - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
- Sektori i Bibliotekës Shkencore
- Prof. Asoc. Aurela Saliq Dekan F.SH.
 - Kryesekretare F.SH.
- Prof. Dr. Albert Qarri Dekan F.E.
 - Kryesekretare F.E.
- Prof. As. Armela Panajoti Dekan F.SH.H.D.
 - Kryesekretare F.SH.H.D.
- Prof.As. Hajdar Kicaj Dekan F.SH.T.N.
 - Kryesekretare F.SH.T.N.

REKTORI
Prof. Dr. Roland ZISI